

VENDIM
Nr.43, datë 25.8.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i ""
Manol Konomi,	Anëtar i ""
Zija Vuci,	Anëtar i ""
Franc Jakova,	Anëtar i ""
Alfred Karamuço,	Anëtar i ""
Halil Kopani,	Anëtar i ""
Kristofor Peçi,	Anëtar i ""
Veli Budo,	Anëtar i ""

Me sekretare Arbenka Lalica më datat 24.12.1996 dhe 28.7.1997, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.52/4 Akti që u përket:

KËRKUES: ORGANIZATA E USHTARAKEVE NË PENSION E TË LIRUAR TE SHQIPERISE, dhe SHOQATA "FLAMURI KOMËTAR", e përfaqësuar nga kryetari z. Vladimir Dule.

PERSONA TË INTERESUAR:

- 1.INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE, i përfaqësuar nga z. Eqeren Vaqarri.
- 2.MINISTRIA E MBROJTJES, e përfaqësuar nga z.Remzi Kruja.
3. MINISTRIA E BRENDËSHME, e përfaqësuar nga z.Plator Bylykbashi.

OBJEKTI:

Deklarimin antikushtetues të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" dhe ligjit nr.7496, datë 3.7.1991 "Për statusin e ushtarakut në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji përfaqësuesit e kërkuësve, përfaqësuesit e personave të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me ligjin nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", ushtarakëve të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ Kombëtar, si dhe familjarëve të tyre në rast vdekje të ushtarakut, u janë dhënë sigurime shoqërore suplementare mbi ato që parashihi në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë". Sipas ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, këto përfitime suplementare u sigurohen ushtarakëve me status sipas ligjit nr.7496, datë 3.7.1991 "Për statusin e ushtarakut në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", sipas të cilit si periudhë e shërbimit me status njihet periudha e shërbimit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Kërkesën për ta deklaruar antikushtetues ligjin nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", për shkak se nuk u njeh sigurime shoqërore suplementare edhe ushtarakëve që kanë dalë në pension para vitit 1991 ose janë larguar nga shërbimi ushtarak pa plotësuar periudhën me status që kërkon ligji (2 vjet për ushtarakët e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme dhe 3 vjet për ushtarakët e Shërbimit Informativ Kombëtar), pra për shkak se shkel parimin kushtetues të barazisë së shtetasve, të sanksionuar në nenin 2 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", Gjykata e gjen të pabazuar. Ligjet për statusin e ushtarakut dhe sigurimet shoqërore suplementare Kuvendi Popullor i ka nxjerrë jo për të bërë dallime ndërmjet ushtarakëve që kanë shërbyer para vitit 1991 dhe atyre me status pas vitit 1991, por për të siguruar funksionimin e rregullt të Forcave të Armatosura në kushtet e reja shoqërore dhe ekonomike të sistemit të ekonomisë së tregut që u vendos në vendin tonë

nga viti 1991, ashtu siç janë parashikuar dhe mund të parashikohen sigurime shoqërore suplementare edhe për kategori të tjera të punonjësve të sektorit shtetëror. Kjo gjithashtu nuk ka të bëjë me dallime ndërmjet personave që kanë punuar në administratën civile para dhe pas vitit 1991, por me dhënie sigurimesh shoqërore suplementare për kryerje të shërbimit në kushte të reja (për të siguruar funksionimin e administratës shtetërore në kushtet e sistemit social të ekonomisë së tregut).

Lidhur me pretendimin e kërkuessave se nuk ka gjetur zbatim në fakt neni 16 i Ligjit "Për statusin e ushtarakut", që ka të bëjë me daljen në pension të parakohshëm të ushtarakëve, Gjykata çmon se ai nuk gjen mbështetje në ligjin kushtetues dhe për pasojë nuk hyn në shqyrtimin e tij.

Përsa i përket mospërputhjeve që kanë Ligjet "Për statusin e ushtarakut në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë" dhe "Për gradat në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", në nocionet "dalje në rezervë" dhe "dalje në lirim", ato duhet të gjejnë zgjidhje me ligje dhe nuk përbëjnë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 24 e vijues të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime plotësimë në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesave të Organizatës së Ushtarakëve në Pension e të Liruar të Shqipërisë dhe Shoqatës "Flamuri Kombëtar".

2. I rekomandohet Këshillit të Ministrave të rishikojë në tërësi legjislacionin për ushtarakët dhe t'i paraqesë Kuvendit Popullor projektligjet përkatëse".

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.